



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,  
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen  
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr.42

Prishtinë, më 12.11.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla – C-203

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi.

**Munguan:** Frashër Krasniqi, Sami Kurteshi dhe Jelena Bontiq.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Rreze Hoxha, GLPS; Behxhet Sh. Shala, KMLDNJ; Arton Demhasaj, Çohu; Vera Manuerco, Shaban Murturi dhe Cezary Michalczuk, EUSR; Vlora Nushi, Opa/UNMIK; Artan Murati, KDI dhe Rabije Kryeziu, RTK.

**Mbledhjen e kryesoi,** Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit.

**Nga stafi mbështetës:** Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr.06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve;
3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr.06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë;
4. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje*

## **2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve**

**Kryetarja** paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente në Projektligjin nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve me gjithsej 19 amendamente. Ka pas një bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, por edhe me Ministrinë e Drejtësisë, natyrisht edhe me anëtarët e grupit të punës dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje.

*Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë:*

### **Rekomandim**

I. Miratohet Raporti me amendamente i komisionit;

II. Projektligjin nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe amendamentet e propozuara, procedohen për shqyrtim sipas kompetencës në komisionet kryesore;

III. Amendamentet e miratuara nga komisioni, janë paraqitur si aneks i këtij procesverbali.

## **3. Shqyrtimi në Raportit me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë**

**Kryetarja** paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje.

**Shkumbin Demaliaj** tha se në këtë projektligj gjithsej janë 26 amendamente duke qenë në koordinim edhe me zyrën e BE-së përmes propozimeve të tyre, por, po ashtu edhe nga grupet e tjera të interesit. Më tej z. Demaliaj tha se duhet të jetë edhe një amendament tjetër te çështja e hyrjes në fuqi duke thënë se nuk ka pasur propozime në lidhje me këtë nen.

*Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni me **4 vota për** dhe **3 abstenime** nxori këtë:*

### **Rekomandim**

I. Miratohet Raporti me amendamente i komisionit;

II. Projektligjin nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë dhe amendamentet e propozuara, procedohen për shqyrtim sipas kompetencës në komisionet kryesore;

III. Amendamentet e miratuara nga komisioni, janë paraqitur si aneks i këtij procesverballi.

#### **4. Të ndryshme**

##### **A. Kërkesë**

Komisioni me propozim të z. **Arben Gashi**, kërkoi nga Kryesia e Kuvendit që brenda kësaj jave, më 14-16 nëntor të caktojë mbledhje plenare me pikat e rendit të ditës, për shkak të rëndësisë që kanë e që ndërlidhet me procesin e liberalizimit të vizave si vijon:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektkodit Penal i Republikës së Kosovës nr. 06/L-074;
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve;
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve; dhe
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:35.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

---

**Albulena Haxhiu**

## **Aneks- Amendamentet e propozuara në Projektligjin nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve**

### **Amendamenti 1**

Neni 3 nënparagrafi 1.7, riformulohet si vijon: “1.7. **Agjencia Kundër Korrupsionit** ose ndonjë autoritet që ka të drejtë të marrë raporte në përputhje me legjislacionin në fuqi, në lidhje me sinjalizimin në sektorin publik, ndërsa rregullatorët sipas fushës në të cilën bëhet sinjalizimi në lidhje me sinjalizimin në sektorin privat.”

Neni 3 nënparagrafi 1.9 riformulohet si vijon:”1.9 **Subjekt privat** – nënkupton shoqëritë tregtare, personat juridikë, sipas ligjit për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare dhe persona të tjerë juridikë të përcaktuar me ligj.

Neni 3 nënparagrafi 1.11, riformulohet si vijon:”1.11. **Veprim i dëmshëm** - çdo veprim apo mosveprim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë që cenon interesin e ligjshëm të sinjalizuesit apo personit të lidhur me sinjalizuesin.

Në nenin 3 nënparagrafi 1.12, në rreshtin e fundit fjalët” për shkak të lidhjes”, zëvendësohen me fjalët “për shkak të çfarëdo lidhjeje” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

### **Amendamenti 2**

Pas nenit 3 të Projektligjit, shtohet një nen i ri 4, me përmbajtjen si vijon:”

#### **“Neni 4**

##### **Parimet e përgjithshme të detyrave dhe përgjegjësive të zyrtarit përgjegjës**

1. Në ushtrimin e funksioneve të tij/saj, zyrtari përgjegjës:

1.1 vepron me ndershmëri, paanshmëri dhe efikasitet, duke pasur parasysh interesat legjitimë të sinjalizimit.

1.2 ruan konfidencialitetin e informatave.

1.3 vepron i pavarur ndaj qëndrimeve politike apo ndaj çfarëdo ndikimi tjetër të padrejtë që mund të pengojë ushtrimin e detyrave të tij/saj nga ky projektligj.

1.4 shmangë çdo lloj konflikti potencial të interesit, dhe zbulon menjëherë para Autoritetit Kompetent, çfarëdo lloj konflikti interesi para fillimit të hetimit administrativ të sinjalizimit.

1.5 ndërmerr të gjitha masat e duhura për të mbrojtur dokumentacionin dhe provat në lidhje me njoftimin e zhdukjes, fshehjes, ndryshimit, falsifikimit dhe veprimeve të tjera që kanë për qëllim shkatërrimin e tyre.”

### **Amendamenti 3**

Në nenin 4 nënparagrafi 1.6, pas fjalës “keqpërdorim” shtohen fjalët “ të detyrës zyrtare apo autoritetit” dhe teksti vazhdon si në projektligj

### **Amendamenti 4**

Neni 5 i projektligjit fshihet dhe renditja e neneve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

### **Amendamenti 5**

Neni 6 paragrafi 1, riformulohet si vijon:”1. Çdo veprim ose mosveprim që synon pengimin e raportimit apo shpalosjes në interes publik, është i pavlefshëm dhe zyrtari përgjegjës apo cildo person tjetër në rastet përkatëse ndiqet penalisht sipas dispozitave penale në fuqi në Kosovë”.

### **Amendamenti 6**

Në nenin 7 paragrafi 1, fjala “gëzon”, zëvendësohet me “ka” dhe teksti vazhdon si në projektligj

Në nenin 7 në paragrafin 2, pas fjalëve “sipas këtij ligji ”, shtohen fjalët “si në vijim:”

### **Amendamenti 7**

Në nenin 8 paragrafi 3, riformulohet si vijon:”3. Zyrtari përgjegjës gëzon të njëjtën mbrojtje ashtu si sinjalizuesi nëse provohet se veprimi i dëmshëm është ndërmarrë kundër tij në lidhje me pranimin dhe trajtimin e sinjalizimit.”

### **Amendamenti 8**

Neni 9 i projektligjit riformulohet si vijon:

#### **Neni 9**

#### **Mbrojtja e sinjalizuesve**

1. Sinjalizuesi që raporton ose shpalos informata në pajtim me dispozitat e këtij ligji, nuk mund të jetë subjekt i përgjegjësisë penale ose civile apo procedurave disiplinore.
2. Sinjalizuesi ka të drejtën e mbrojtjes sipas këtij ligji, në rastet kur:
  - 2.1 raporton ose shpalos informacion, siç është përcaktuar me këtë ligj;
  - 2.2. me arsye beson se informacioni i raportuar apo i shpalosur është i vërtetë.
3. Sinjalizuesi nuk është i detyruar të provojë mirëbesimin dhe vërtetësinë e informacionit të sinjalizuar.

4. Mbrojtja e garantuar për sinjalizuesin sipas këtij ligji nuk duhet të paragjykohet nëse kërcënimi apo cenimi i interesit publik i pretenduar nuk është materializuar.

#### **Amendamenti 9**

Në nenin 11 paragrafi 4, riformulohet si vijon:

4 “Në rastet kur kërkohet me ligj të zbulohet identiteti i sinjalizuesit, zyrtari përgjegjës njofton sinjalizuesin për këtë fakt para si t’ia zbulojë identitetin.”

#### **Amendamenti 10**

Neni 12, paragrafi 3, në rreshtin e fundit pas fjalës “e tilla,” shtohen fjalët” dhe duhet ti arsyetojë ato”

#### **Amendamenti 11**

Neni 16 paragrafi 3, në rreshtin e pestë dhe të gjashtë, shkronja “w” zëvendësohet me shkronjën “ë”.

#### **Amendamenti 12**

Në nenin 17 paragrafi 1, në rreshtin e dytë fjalët “tridhjetë (30)” zëvendësohen me fjalët “pesëmbëdhjetë (15) dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

#### **Amendamenti 13**

Neni 21 riformulohet si vijon:”

#### **Neni 21**

#### **Sinjalizimi lidhur me sigurinë kombëtare, mbrojtjen, inteligjencën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare**

1. Kur sinjalizimi i brendshëm apo jashtëm sipas këtij ligji ka të bëjë me informacionin e klasifikuar, sigurinë kombëtare, mbrojtjen, inteligjencën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, sinjalizuesi ia paraqet organit kompetent në këto fusha.

2. Brenda 6 muajve institucionet përgjegjëse sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të përcaktojnë rregulla dhe procedura për pranimin dhe trajtimin e llojeve të sinjalizimeve. Nëse nuk përcaktohen rregullat dhe procedurat, aplikohen rregullat e përgjithshme në përputhje me këtë ligj.

#### **Amendamenti 14**

Neni 24 riformulohet si vijon:”

#### **Neni 24** **Mbrojtja gjyqësore**

1. Sinjalizuesi dhe personi i lidhur me sinjalizuesin i cili ka pësuar nga veprimet e dëmshme në lidhje me sinjalizimin, ka të drejtë në mbrojtje gjyqësore, pa qenë i detyruar të shterojë mjetet juridike të brendshme në procedurë administrative.

2. Padia kundër veprimit të dëmshëm i paraqitet gjykatës në afat prej 6 (gjashtë) muajsh nga dita kur sinjalizuesi është vënë në dijeni por jo më vonë se 3 (tri) vite nga dita kur është ndërmarrë veprimi i dëmshëm.

2.1 Për rastet që kanë të bëjnë me shërbyes civilë, padia dorëzohet në Departamentin për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

2.2 Për rastet që kanë të bëjnë me kategori të tjera të të punësuarve, padia dorëzohet në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore, ku ndodhet selia e punëdhënësit apo ku sinjalizuesi e ka vendbanimin.

3. Krahas padisë nga paragrafi 2 i këtij neni, sinjalizuesi mund të bëjë edhe kërkesë për kompensim të dëmit.

4. Në rastet kur gjykata kompetente vërteton se sinjalizuesi në kontekst të marrëdhënies së punës ka pësuar nga veprime të dëmshme për shkak të sinjalizimit, vendos, sipas rastit, që ta kthejë në vendin e tij të punës, t’ia kompensojë dëmin e shkaktuar dhe të urdhërojë institucionin publik apo subjektin privat të ndërmarrë veprime të caktuara.

5. Të gjitha lëndët që kanë të bëjnë me sinjalizimin, trajtohen me prioritet nga Gjykata.”

#### **Amendamenti 15**

Neni 25 riformulohet si vijon:”

#### **Neni 25** **Barra e provës**

1. Në të gjitha rastet kur sinjalizuesi ose personi i lidhur me sinjalizuesin konsideron se ka pësuar nga veprime të dëmshme për shkak të sinjalizimit, punëdhënësi e ka barrën e provës të provojë se veprimi i dëmshëm nuk ka lidhje shkakore me sinjalizimin.”

#### **Amendamenti 16**

Neni 26 riformulohet si vijon:”

#### **Neni 26** **Sigurimi i kërkesëpadisë dhe masa e sigurimit**

1. Sinjalizuesi dhe personi i lidhur me sinjalizuesin, mund të paraqesë propozim për caktimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë dhe masës së sigurimit në gjykatën kompetente.

2. Në lidhje me masën e sigurimit të kërkesëpadisë dhe masën e sigurimit zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore dhe të ligjit për konfliktet administrative.

3. Sinjalizuesi lirohet nga detyrimi për deponimin e garancisë në gjykatë për shkak të paraqitjes së propozimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

### **Amendamenti 17**

Neni 27, riformulohet si vijon:”

#### **Neni 27**

#### **Dispozitat kundërvajtëse**

1. Gjykata kompetente shqipton gjobë prej 500 (pesëqind) euro deri në 20.000 (njëzetmijë) euro për institucionin publik apo subjektin privat si dhe autoritetin kompetent përkatës, në rast se:

1.1 nuk mbron sinjalizuesin nga ndonjë veprim i dëmshëm ose nuk ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për ndërprerjen e veprimit të dëmshëm, si dhe eliminimin e çdo pasoje të veprimit të dëmshëm, brenda kompetencave të veta;

1.2 nuk njofton me shkrim të gjithë të punësuarit, lidhur me të drejtat që parashihen me këtë ligj;

1.3 nuk cakton zyrtarin përgjegjës;

1.4 nuk ndërmerr veprime pas raportimit të informacionit brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj;

1.5 nuk informon sinjalizuesit për rezultatin e procedurës, brenda afatit të përcaktuar;

1.6 nuk informon sinjalizuesit, sipas kërkesës së tij, lidhur me ecurinë dhe veprimet e ndërmarra në procedurë, ose nuk i mundëson sinjalizuesit që të ketë qasje në shkresat e lëndës dhe që të marrë pjesë në veprimet e ndërmarra gjatë procedurës së sinjalizimit.

1.7 Në rast se pengon sinjalizimin, siç përcaktohet me neni 6 të këtij ligj;

1.8 Në rast se vepron në kundërshtim me nenin 11 të këtij ligji.

2. Zyrtari përgjegjës i institucionit publik, subjektit privat si dhe i autoritetit kompetent përkatës dënohet me gjobë prej 300 (treqind) euro deri në 2.000 (dymijë) euro në rastet kur është përgjegjës sipas nënparagrafëve 1.1, 1.2 dhe 1.4 deri në 1.6 të paragrafit 1 të këtij neni.

3. Kërkesa për fillimin e procedurës së kundërvajtjes paraqitet në Gjykatën kompetente nga Agjencia kundër Korrupsionit për sektorin publik dhe Inspektorati i Punës për sektorin privat.

4. Nëse brenda 60 ditëve institucionet përgjegjëse nuk ndërmarrin asnjë veprim apo refuzojnë të veprojnë atëherë sinjalizuesi mund të iniciojë vetë procedurën.



5. Nëse personi përgjegjës është recidivistë, ndaj tij mund të shqiptohet sanksioni kundërvajtës me gjobë deri në shumën e dyfishuar të paraparë me këtë nen.

### **Amendamenti 18**

Neni 29 paragrafi 1, fjalët “31 janar”, zëvendësohet me fjalët “ 31 dhjetor” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Neni 29 paragrafi 2, në fund të paragrafit shtohen fjalët “ më së voni deri me 31 janar”

### **Amendamenti 19**

Neni 30, riformulohet si vijon:”

### **Neni 30 Aktet nënligjore**

1. Aktet nënligjore për zbatim të këtij ligji, do të nxirren brenda 6 (gjashtë) muajve prej ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Në afat prej 6 (gjashtë) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, punëdhënësit sipas këtij ligj caktojnë zyrtarët përgjegjës për sinjalizim dhe e njoftojnë AKK-në për sektorin publik, përkatësisht Inspektoratin e Punës për sektorin privat.
3. Agjencia kundër Korrupsionit dhe Inspektorati i Punës, obligohen të fillojnë procedurat sipas ligjit për kundërvajtje ndaj punëdhënësve dhe zyrtarëve përgjegjës të cilët nuk i kane përmbushur obligimet sipas këtij ligji, jo më vonë se 6 muaj.

## **Aneks- Amendamentet e propozuara në Projektligjin nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë**

### **Amendamenti 1**

Në nenin 1, shtohet një paragraf i ri si vijon: “2. Ky ligj, po ashtu implementon Direktivën 2014/42/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 3 prill 2014 mbi ngrirjen dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave të krimit në Bashkimin Evropian.”

### **Amendamenti 2**

Në nenin 2, nënparagrafi 1.15, fjala “Bashkëkryerja”, zëvendësohet me fjalën “Tentimi” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

### **Amendamenti 3**

Në nenin 3, nëparagrafi 1.3, fjalët: “kundër të cilit është iniciuar një hetim penal ose”, hiqen dhe teksti vazhdon si në projektligj.

#### **Amendamenti 4**

Neni 3, nënparagrafi 1.6, pas fjalëve “mund të realizohet”, shtohen fjalët “*në tërësi apo pjesërisht*” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

#### **Amendamenti 5**

Në nenin 3, pas nënparagrafit 1.10, shtohet një nënparagraf i ri 1.11, me përmbajtjen si vijon:”1.11 **Sekuestrimi i përkohshëm** - statusi ligjor i pasurisë që është konfiskuar nga policia dhe që është nën kontrollin e tyre ose në kujdestarinë sipas urdhrorit të përkohshëm kufizues të lëshuar nga prokurori i Shtetit, në pajtim me nenin 8 të këtij ligji”.

#### **Amendamenti 6**

Në nenin 5, paragrafi 3 riformulohet si vijon: “3. I pandehuri dhe çdo palë e tretë që pretendon të ketë një interes ligjor në pasurinë e përfshirë në kërkesën për verifikimin e pasurisë, kanë të drejtë të jenë të pranishëm në seancën dëgjimore për verifikimin e pasurisë”.

#### **Amendamenti 7**

Në nenin 5, paragrafi 4 riformulohet si vijon: “4. Gjatë seancës dëgjimore për verifikim të pasurisë, fillimisht i kërkohet prokurorit të Shtetit të provojë, duke i vlerësuar gjasat që secila pjesë e pasurisë e paraqitur në kërkesën për verifikim të pasurisë është pronë e të pandehurit, siç përcaktohet në nenin 3, nënparagrafin 1.5 të këtij ligji.”

#### **Amendamenti 8**

Në nenin 5, nënparagrafët 6.1 dhe 6.2, në rreshtin e tretë, fjala “pasuri”, zëvendësohet me fjalën “pronë” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Në nenin 5, paragrafi 7, në rreshtin e tretë, fjala “gjykimit”, zëvendësohet me fjalën “shqyrtimit” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Në nenin 5, paragrafi 8 riformulohet si vijon: “8 Nëse paraqitet nevoja, gjykata mund të caktojë ekspert, dhe në bazë të propozimit nga palët, mund t’i thërrasë dëshmitarë në seancën dëgjimore për verifikim të pasurisë. Ekzaminimi i provave të tilla bëhet në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, përveç nëse ato janë në kundërshtim me dispozitat e nenit 18 të këtij ligji.”

#### **Amendamenti 9**

Neni 6, paragrafi 1, në rreshtin e tretë, fjala “arsyeshëm”, zëvendësohet me fjalën “arsyetuar” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Neni 6, paragrafi 2, në rreshtin e pestë, fjalët “mundur të përmbushin”, zëvendësohen me fjalën “përmbushur” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Neni 6, paragrafi 5 riformulohet si vijon: “ 5. Nëse i pandehuri ose cilado palë e tretë e cila ka pranuar pasuri të transferuara nuk i përmbush detyrimet e tij/saj, siç përcaktohet në paragrafin 4 të këtij neni:

5.1. Gjykata konfiskon çdo pasuri tjetër të të pandehurit ose çdo pasuri tjetër të palës së tretë, e cila ka pranuar pasuri të transferuara, që përputhet me vlerën zëvendësuese.

5.2. Prokurori i Shtetit mundet në çdo kohë, pas aktvendimit nga paragrafi 1 i këtij neni, të kërkojë konfiskimin e çdo pasurie të të pandehurit ose të palës së tretë deri në vlerën monetare të përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni.”

Neni 6, paragrafi 7, në rreshtin e dytë, fjala “përshtatshmërisht”, hiqet dhe zëvendësohet me fjalët “*mutatis mutandis*” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Neni 6, pas paragrafit 7, shtohet një paragraf i ri 8, me përmbajtjen si vijon:” 8 Ndaj vendimit të ankimuar, të përcaktuar në paragrafin 6 të këtij neni, nuk mund të paraqitet mjete jashtëzakonshëm.”

#### **Amendamenti 10**

Neni 7, paragrafi 2, në fund të paragrafit, shtohen fjalët: “dhe në pajtim me nenin 11 të këtij ligji.”

#### **Amendamenti 11**

Neni 8, paragrafi 2, në rreshtin e tretë, fjala “trupërore”, zëvendësohet me fjalën “trupore” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Neni 8, nënparagrafi 2.1, në rreshtin e gjashtë, fjala “pasuriat”, zëvendësohet me fjalën “pasuritë” dhe në rreshtin e njëmbëdhjetë, fjala “prosive”, zëvendësohet me fjalën “porosive” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Neni 8, nënparagrafi 2.2 riformulohet si vijon:” 2.2 Instrumente ligjore që evidentojnë interes në çfarëdo prone, përfshirë, por jo të kufizuar në titull, aktin e pronësisë, hipotekë, servitute ose interes në një pronë dhe të drejta për të përdorur pasuritë në pronësi shoqërore, pronësi publike dhe shtetërore.

Neni 8, nënparagrafi 3.2, riformulohet si vijon: “Transferimin e pronësisë së pasurisë;”

Në nenin 8, nënparagrafët 3.1, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, 3.7 dhe 3.8, hiqen fjalët “së specifikuar;”

Neni 8, nënparagrafi 5.2, riformulohet si vijon:” 5.2 Përshkruaj provat që provojnë dyshimin e bazuar të përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni;

Neni 8, nënparagrafi 5.6, në rreshtin e parë, fjala “Deklaron”, zëvendësohet me fjalën “Përcakton” dhe teksti vazhdon si në projektligj

Neni 8, paragrafët 6 dhe 7, fuzionohen me formulimin si vijon:”6. Urdhri kufizues i përkohshëm i lëshuar nga prokurori i Shtetit mund të përfshijë sekuestrimin e përkohshëm të pasurisë, i cili ekzekutohet nga policia, e cila kujdeset për pasurinë dhe mirëmban pasurinë.”

*Renditja e paragrafëve dhe nënparagrafëve bëhet sipas numrave me radhë.*

Neni 8, paragrafi 7.2,hiqen fjalët “sëspecifikuar”.

Neni 8, pas paragrafit 8 të projektligjit, shtohet një paragraf i ri me përmbajtjen si vijon: “Nëse personi ose entiteti i cili posedon pasuri që i nënshtrohet sekuestrimit të përkohshëm në një urdher të kufizimit të përkohshëm, të lëshuar nga një prokuror i Shtetit, siç është detajuar në paragrafin 6 të këtij neni, refuzon t’ia dorëzojë pasurinë zyrtarit të autorizuar të policisë, përgjegjës për ekzekutimin e urdhrin, ai person ose subjekti i nënshtrohet ndjekjes penale për pengimin e provave ose procedurave zyrtare sipas Kodit Penal dhe një gjobë nga gjyqtari i procedurës paraprake deri në pesëdhjetë për qind (50%) të vlerës së pasurisë. Personi ose subjekti që i nënshtrohet një gjobe të tillë,kanë të drejtë ankese brenda 7 (shtatë) ditëve nga shqiptimi i tij ose mund të anulojë gjobën duke respektuar urdhrin e kufizimit të përkohshëm menjëherë, por jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga momenti i vendimit të shqiptuar që bën gjobën përfundimtare.”

Neni 8, paragrafi 9 riformulohet si vijon:”9.Prokurori i Shtetit paraqet kërkesë për urdher kufizues përfundimtar nga neni 9i këtij ligji, brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh nga nxjerrja e urdhrin kufizues të përkohshëm. Nëse prokurori ka kërkuar për një urdher kufizues përfundimtar, urdhrin kufizues i përkohshëm dhe sekuestrimi i përkohshëm i çfarëdo pasuriembetet i vlefshëm deri në momentin kur gjykata vendos mbi kërkesën për urdher kufizues përfundimtar.”

Neni 8, paragrafi 10 riformulohet si vijon: ”10.Nëse prokurori i Shtetit nuk paraqet një kërkesë për një urdher kufizues përfundimtar, siç përcaktohet në nenin 9 të këtij ligji, urdhrin kufizues i përkohshëm nuk është më i vlefshëm dhe çdo pasuri e përfshirë në urdhrin kufizues lirohet prej urdhrin kufizues të përkohshëm dhe i kthehen pronarit dhe çdo pronë e sekuestruar përkohësisht, përfshirë në urdhrin kufizues të përkohshëm, i kthehet pronaritapo poseduesit të pasurisë, përveç nëse pasuria i nënshtrohet konfiskimit automatik, siç përcaktohet në nenin përkatës të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.”

Neni 8, paragrafi 12, në fund të paragrafit, fjala “përbashkët”, zëvendësohet me fjalën “ndërsjellë”.

## **Amendamenti 12**

Neni 9, paragrafi 4, në rreshtin e njëmbëdhjetë, fjala “lajmesh”, hiqet dhe teksti vazhdon si në projektligj.

## **Amendamenti 13**

Titulli i nenit 10, riformulohet si vijon: **“Masat e Përkohshme për të Siguruar Pronën”**

Neni 10, paragrafi 1, pas fjalëve “pasuritë e sekuestruara”, shtohet fjala “përkohësisht” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Neni 10, paragrafi 2 riformulohet si vijon: “2. Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, është përgjegjëse për administrimin e çdo prone të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, në pajtim me ligjin në fuqi për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar.”

Neni 10, paragrafi 3, pas fjalëve “pasurisë së sekuestruar”, shtohet fjala “përkohësisht” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Neni 10, nënparagrafi 3.5, riformulohet si vijon:” Shitja ose tjetërsimi i pasurisë sipas paragrafëve 4-7 të këtij neni; ose”

Neni 10, paragrafi 8, fjalët “, përveç nëse parashikohet ndryshe në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës”, **hiqen.**

#### **Amendamenti 14**

Neni 11, titulli riformulohet si vijon: **“Të drejtat e të pandehurit dhe palëve të treta para lëshimit të urdhrin kufizues përfundimtar”.**

Neni 11, paragrafi 1, pas fjalëve “(15) ditësh”, shtohen fjalët “është shërbyer me”, kurse fjalët “pasi ka pranuar”, hiqen, dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Neni 11, nënparagrafi 1.1, në rreshtin e tretë dhe në nënparagrafin 1.2, në rreshtin e dytë, fjala “pasuri”, zëvendësohet me fjalën “pronë”.

#### **Amendamenti 15**

Neni 12, nënparagrafi 1.2, në rreshtin e dytë, fjala “detajuar”, zëvendësohet me fjalën “përcaktuar” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Neni 12, paragrafi 3, fjalët “pasuri të sekuestruara”, zëvendësohen me fjalët “pasurinë e sekuestruar përkohësisht” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Neni 12, nënparagrafët 3.2, në rreshtin e tretë dhe nënparagrafi 3.3, në rreshtin e tretë dhe të gjashtë, pas fjalës “sekuestruara”, shtohet fjala “përkohësisht”.

#### **Amendamenti 16**

Neni 13, riformulohet si vijon:

**“Neni 13**

## **Urdhri Kufizues Përfundimtar**

1. Urdhri kufizues përfundimtar duhet të:

1.1 Përshkruan pasurinë e përfshirë në urdhrin kufizues përfundimtar;

1.2 Përshkruan provën e artikulueshme, e cila demonstroi dyshimin e bazuar, të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 8 të këtij ligji dhe domosdoshmërinë për urdhrin e kufizimit përfundimtar;

1.3 Urdhëron marrësin e urdhrin për të përmbushur kushtet e urdhrin;

1.4 Përshkruan të gjithë personat që mund të kenë një interes në pasuri;

1.5 Përcakton datën dhe orën e lëshimit të urdhrin;

1.6 dërgohet te prokurori i Shtetit, i pandehuri dhe çdo palë të tretë të emërtuar në urdhër;

1.7 Përshkruan masat e përkohshme për të siguruar pasurinë e sekuestruar të përkohshme;

1.8 Nëse është e nevojshme, përmban arsyetimin për atë se përse kërkesa për lëshimin e urdhrin në lidhje me një send të veçantë të pasurisë është refuzuar.

2. Një urdhër kufizues përfundimtar do të ketë efektet në vijon:

2.1 Çdo bankë ose institucion financiar që pranon urdhrin kufizues përfundimtar do të veprojë në përputhje me urdhrin dhe do të parandalojë menjëherë çdo aktivitet të mëtejshëm me llogarinë bankare ose çdo pronë tjetër të përshkruar në urdhër i cili e zvogëlon shumën e parave në llogarinë bankare, ose zvogëlon vlerën e pasurisë; dhe

2.2 Çdo palë tjetër e cila pranon urdhrin kufizues përfundimtar do të veprojë në përputhje me kushtet e urdhrin.

3. Urdhri kufizues përfundimtar mund të përfshijë pasurinë që ndodhet në një shtet ose territor jashtë Republikës së Kosovës.

4. Urdhri kufizues përfundimtar mbetet në fuqi deri në kohën kur ndryshohet ose anulohet me një urdhër tjetër të lëshuar nga gjykata kompetente.

5. Urdhri kufizues përfundimtar thekson: "Pasuria e listuar në urdhrin e bashkangjitur të kufizimit është kufizuar dhe ju nuk jeni i lejuar të merreni me të. Nëse keni ndërmend të sfidoni kufizimin e kësaj pasurie, ju duhet të dorëzoni një ankesë në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit."

### **Amendamenti 17**

**Neni 14 riformulohet si vijon:**

## “Neni 14

### Urdhri Kufizues i Përkohshëm për pasurinë shtesë

1. Në vijim të lëshimit të një urdhri kufizues të përkohshëm, në çdo kohë gjatë hetimit penal, pasi të jetë ngritur aktakuza, gjatë shqyrtimin kryesor dhe në vijim të përmbylljes së shqyrtimit kryesor brenda të njëjtit afatkohor, të përshkruar në nenin 4 të këtij ligji, nëse plotësohen kushtet nga neni 8 i këtij ligji, një prokuror i Shtetit mund lëshojë një urdhër kufizues të përkohshëm për pasuri shtesë të të pandehurit, siç përshkruhet në nenin 3, nënparagrafin 1.5 të këtij ligji.

2. Në vijim të lëshimit të urdhrin të kufizues të përkohshëm shtesë, zbatohen dispozitat e nenit 9 dhe nenit 11 të këtij ligji.”

### Amendamenti 18

**Neni 15, riformulohet si vijon:**

## Neni 15

### Urdhri kufizues përfundimtar për pasurinë shtesë

Me pranimin e kërkesës së prokurorit të Shtetit për një urdhër shtesë kufizues përfundimtar të përcaktuar në nenin 14 të këtij ligji, gjykata vepron në përputhje me kërkesat e nenit 12 dhe 13 të këtij ligji”.

### Amendamenti 19

**Neni 16 riformulohet si vijon:**

## Neni 16

### Arsyet e ankesës kundër lëshimit ose mohimit të urdhrin kufizues përfundimtar

1. Prokurori i Shtetit, i pandehuri dhe çdo palë e tretë, e përcaktuar në urdhrin kufizues përfundimtar, mund të paraqesë ankesë kundër lëshimit ose refuzimi të urdhrin, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga **dita e shërbimit me urdhrin** me shkrim.

2. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e urdhrin. Dispozitat e kapitullit për mjetet juridike të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, zbatohen *mutatis mutandis*.

3. I pandehuri ose një palë e tretë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të paraqesë ankesë vetëm nëse:

3.1 Prokurori i Shtetit nuk ka provuar dyshimin e bazuar, të përshkruar në paragrafin 4 të nenit 8 të këtij ligji;

3.2 Prokurori i Shtetit nuk ka provuar nevojshmërinë e përshkruar në nënparagrafin 5.3 të nenit 8 të këtij ligji; ose

- 3.3. I pandehuri ose pala e tretë ka dëshmuar mbi bazën e vlerësimit të gjasave, kushtet e detajuara në paragrafin 1 të nenit 11 të këtij ligji.
4. Prokurori i Shtetit, sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të paraqesë ankesë vetëm nëse:
- 4.1 Prokurori i Shtetit ka provuar dyshimin e bazuar të përshkruar në paragrafin 4 të nenit 8 të këtij ligji;
- 4.2 Prokurori i Shtetit ka provuar nevojshmërinë e përshkruar në nënparagrafin 5.3 të nenit 8 të këtij ligji; ose
- 4.3 I pandehuri ose pala e tretë nuk ka dëshmuar mbi bazën e vlerësimit të gjasave, kushtet e detajuara në paragrafin 1 të nenit 11 të këtij ligji.

## **Amendamenti 20**

Neni 17, paragrafi 1 riformulohet si vijon:

“1.Nëse prokurori i Shtetit ka dyshimin e arsyeshëm se mund të bëhet një kërkesë për verifikim të pasurisë sipas nenit 4 të këtij ligji, mund të iniciojë një hetim për konfiskim:

1.1Në çfarëdo faze të hetimit penal;

1.2Pasi është ngritur aktakuza;

1.3Para shqyrtimin kryesor;

1.4Gjatë shqyrtimin kryesor; dhe

1.5Pas përmbylljes së shqyrtimin kryesor dhe brenda kufizimit kohor të përcaktuar në nenin 4 të këtij ligji.”

Neni 17, paragrafi 2, në rreshtin e dytë, fjala “pronën”, zëvendësohet me “pasurinë” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

## **Amendamenti 21**

Neni 18, paragrafi 1 riformulohet si vijon:”1.Prokurori i Shtetit mund të kërkojë urdhër për zbulim të informacionit, si pjesë e hetimit të konfiskimit.”

Në nenin 18, nënparagrafi 2.3, në rreshtin e pestë, pas fjalës “specifikuar”, shtohen fjalët” ose menjëherë” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Në nenin 18, nënparagrafi 8.2, riformulohet: “8.2 gjobë prej 50.000 (pesëdhjetë mijë)euro;”

Neni 18, paragrafi 7 riformulohet si vijon:”7.Një person kryen vepër penale nëse, duke pretenduar se vepron në përputhje me një kusht të imponuar, atij ose asaj, në bazë të një urdhri për zbulim të informacionit, ai ose ajo bën një deklaratë të cilën ai ose ajo e di, ose ka arsye të dyshojë, se është e rreme ose keq-informuese në një të dhënë materiale.”



Në nenin 18, pas paragrafit 8, shtohet një paragraf i ri, me përmbajtjen si vijon:”9.Një person nuk mund të refuzojë zbatimin e një urdhri për dhënien e informacioneve shpjeguese, me arsyetimin se pajtueshmëria do ta inkriminonte atë person në kryerjen e një vepre penale. Çdo informacion ose material i siguruar nga personi, në pajtim me urdhrin për dhënien e informacioneve, nuk do të jetë i pranueshëm në asnjë procedurë penale kundër atij personi, përveç nëse informacioni i dhënë tejkalon qëllimin e urdhrin për dhënien e informacionit.”

*Renditja e paragrafëve në vazhdim, bëhet sipas numrave.*

## **Amendamenti 22**

Neni 19, nënparagrafi 1.3 riformulohet si vijon: ” Është i paarritshëm ose nuk është prezent në Republikën e Kosovës; ose”.

Neni 19, paragrafi 5 riformulohet si vijon: ”5.Nëse pasuria nuk i nënshtrohet një urdhri kufizues të përkohshëm ose përfundimtar, me qëllim të konfiskimit të zgjeruar, prokurori do të ketë 90 (nëntëdhjetë) ditë nga dita kur Zyrës së Prokurorit i bëhet i ditur informacioni në lidhje me një nga rastet e përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni, që të nxjerrë një urdhër kufizues të përkohshëm, në përputhje me nenin 8 ose 14 të këtij ligji.”

Neni 19, paragrafi 7 riformulohet si vijon: ”7. Nëse nuk është ngritur një aktakuzë, prokurori do të ketë 180 (njëqind e tetëdhjetë)ditë nga dita e vendimit të gjykatës nga paragrafi 6 i këtij neni, për të ngritur një aktakuzë, e cila përshkruan pasuritë që i nënshtrohen konfiskimit të zgjeruar. Gjykata zhvillon shqyrtimin kryesor, në pajtim me Kodin e Procedurës Penale.”

Neni 19, paragrafi 8 riformulohet si vijon: “8. Nëse aktakuza përfshin veprat penale të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 2 të këtij ligji dhe është ngritur parase të ndodhë njëri nga rastet e përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni, gjykata merr vendim në pajtim me paragrafin 6 të këtij neni dhe zhvillon shqyrtimin kryesor, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale”.

Neni 19, paragrafi 10 riformulohet si vijon: ”10 Nëse gjykata përcakton se i pandehuri ka kryer veprën penale, ajo jep një aktgjykim, i cili deklaron se i pandehuri ka kryer veprën penale. Për qëllimet e nenit 2 të këtij ligji ,ky aktgjykim do të jetë ekuivalent me një aktgjykim fajësie.”

Neni 19, paragrafi 11,në rreshtin e shtatë, fjala”përshtatshëmrisht”, zëvendësohet me fjalët “*mutatis mutandis*”.

## **Amendamenti 23**

Neni 20 riformulohet si vijon:

### **Neni 20**

#### **Kushtet kur pasuria i nënshtrohet konfiskimit në rastet e vdekjes, mungesës, çrregullimit ose paaftësisë mendore të të pandehurit**

1. Në rastet kur ka pasuri që mund t’i nënshtrohen urdhrin kufizues të përkohshëm ose përfundimtar, një urdhër shtesë, sekuestrim përkohshëm, konfiskim i përkohshëm ose çfarëdo

mase tjetër e përkohshme, me qëllim të konfiskimit përfundimtar, ose kur është ngritur një aktakuzë e cila përshkruan pasuritë që i nënshtrohen konfiskimit, por që procedurat penale nuk mund të vazhdojnë, sepse i pandehuri:

- 1.1 Ka vdekur;
- 1.2 Është arratisur nga Republika e Kosovës;
- 1.3 Është i paarritshëm ose jo prezent në Republikën e Kosovës; ose
- 1.4 Vuan nga një çrregullim ose paaftësi mendore.

Gjykata mund të vazhdojë procedurat penale, me qëllim të konfiskimit të përfitimeve materiale ose të mjeteve për kryerjen e veprës penale.

2. Në rastet e detajuara në paragrafin 1 të këtij neni, zbatohen dispozitat në vijim:

2.1 Për një të pandehur që ka vdekur, nëse nuk është angazhuar një avokat nga trashëgimtarët ligjorë të të vdekurit, gjykata do të caktojë ose vazhdojë caktimin e një avokati për të përfaqësuar interesat e të vdekurit.

2.2 Për një të pandehur që ka ikur nga Republika e Kosovës ose është i pagjurmueshëm, ose i cili nuk është prezent në Kosovë, ose i cili vuan nga një çrregullim, ose paaftësi mendore, gjykata do të caktojë ose vazhdojë caktimin e një avokati për të përfaqësuar interesat e të pandehurit ose të palës së tretë.

3. I pandehuri përfaqësohet nga avokati i caktuar, në pajtim me nënparagrafët 2.1 dhe 2.2 të këtij neni. Avokati gëzon të drejtat e të pandehurit ose të palës së tretë, të përfaqësuar nga ai ose ajo. Avokati do të veprojë në interesat më të mirë të trashëgimtarit ligjor të të pandehurit të vdekur ose të të pandehurit.

4. Në bazë të propozimit nga prokurori i Shtetit ose pala e dëmtuar, gjykata duhet të vazhdojë procedurën penale dhe procedurën për konfiskimin të përfitimeve materiale ose të mjeteve për kryerjen e veprës penale, nëse:

- 4.1 vlera e pasurisë që është objekt i konfiskimit të zgjeruar e kalon (10,000) EUR; dhe
- 4.2 është në interes të drejtësisë që të vazhdohet me procedurat;

5. Nëse pasuria nuk i nënshtrohen një urdhri të përkohshëm ose përfundimtar të kufizimit, ose ndonjë mase tjetër të përkohshme, siç është përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, me qëllim të konfiskimit, prokurori ka 90 (nëntëdhjetë) ditë nga dita kur informacioni lidhur me rastet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, është i njohur për Zyrën e Prokurorit për të lëshuar urdhër ose kërkesë për pasurinë, që të t'i nënshtrohet urdhrin kufizues të përkohshëm ose përfundimtar

ose çfarëdo mase tjetër të përkohshme, siç është përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, me qëllim të konfiskimit.

6. Nëse kushtet e specifikuara në paragrafin 4 të nenit aktual janë përmbushur, gjykata merr një vendim për të vazhduar procedurën penale dhe deklaron vlerën e pasurisë që i nënshtrohet konfiskimit dhe atë se përse është në interesin e drejtësisë që procedurat të vazhdohen.

7. Nëse nuk është ngritur një aktakuzë, prokurori do të ketë 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë nga dita e vendimit të gjykatës nga paragrafi 6 i këtij neni, për të ngritur një aktakuzë ku përshkruhen pasuritë e specifikuara që i nënshtrohen konfiskimit. Gjykata zhvillon shqyrtimin kryesor në pajtim me Kodin e Procedurës Penale.

8. Nëse aktakuza është ngritur para se të ndodhë njëri nga rastet e përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni, gjykata merr vendim në pajtim me paragrafin 6 të këtij neni dhe zhvillon një shqyrtimin kryesor në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.

9. Dispozita e Kodit të Procedurës Penale për hetimin e konfiskimit zbatohet mutatis mutandis.

10. Gjykata merr parasysh vetëm akuzat në aktakuzë që mbështesin konfiskimin e pasurisë.

11. Nëse gjykata përcakton se i pandehuri ka kryer veprën penale dhe pasuritë që i nënshtrohen konfiskimit kanë qenë përfitim material ose mjete për të kryer veprën penale, nxjerr aktgjykim, i cili:

11.1. Përcakton se i pandehuri ka kryer një vepër penale;

11.2. Përcakton se pasuritë janë fituar nga kryerja e veprës penale nga nënparagrafi 11.1 i këtij neni, ose kanë qenë mjete për kryerjen e kësaj vepre penale;

11.3. Specifikon llojin e pasurive dhe vlerën e tyre monetare;

11.4. Urdhëron që kjo pasuri të transferohet në pronësi të Republikës së Kosovës ose na atë të palës së dëmtuar;

11.5. Detyron palët e treta që t'ia dorëzojnë pasuritë Republikës së Kosovës ose palës së dëmtuar, nëse ato nuk janë transferuar sipas nën-paragrafit 11.4 të këtij neni, ose të paguajnë vlerën monetare të pasurisë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data kur aktgjykimi është bërë përfundimtar; dhe

11.6. Urdhëron që të bëhen ndryshimet respektive mbi të drejtat pronësore në regjistrat publikë të gjykatës apo organit tjetër për llogari të Republikës së Kosovës ose palës së dëmtuar, siç është më e përshtatshme.

12. Kundër aktgjykimit nga paragrafi 11 i këtij neni lejohet të bëhet ankesë. Dispozitat e kapitullit për mjetet juridike të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, zbatohen *mutatis mutandis*.

13. Nëse i pandehuri nuk gjendet në ndonjërin nga situatat e paraqitura në paragrafin 1 të këtij neni, ai ose ajo do të ketë të drejtën absolute që të gjykohet përsëri nga një panel tjetër gjyqësor.

14. Në rastin kur i pandehuri nuk dënohet për akuzat e renditura në aktakuzë, të cilat e mbështesin konfiskimin e pasurive, gjykata e anulon aktgjykimin e dhënë sipas paragrafit 11 të këtij neni dhe ia kthen pasuritë të pandehurit.

15. Në rast se pasuritë nuk janë më në dispozicion për t'u kthyer, i pandehuri ka të drejtën për kompensim për dëmet e shkaktuara nga konfiskimi i pajustificuar, në përputhje dhe *mutatis mutandis* me dispozitat relevante të Kodit të Procedurës Penale.

#### **Amendamenti 24**

**Neni 21 riformulohet si vijon:**

#### **Neni 21**

#### **Bashkëpunimi Juridik Ndërkombëtar**

1. Urdhrat e përkohshëm dhe përfundimtar kufizues dhe urdhrat për konfiskim të lëshuar në pajtim me këtë ligj, mund të përfshijnë pasuri që ndodhen si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Kosovës.
2. Në çdo rast të përcaktuar nga ky ligj, në rastet kur pasuria ndodhet në një vend apo territor jashtë Republikës së Kosovës, autoriteti kompetent kërkon ndihmë nga qeveria e atij shteti ose territori për të zbatuar urdhrin kufizues të përkohshëm dhe përfundimtar ose urdhrin për konfiskim në territorin e shtetit të tillë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale të Republikës të Kosovës.”

#### **Amendamenti 25**

Neni 22, paragrafi 1, fjalët “urdhri për pasurit”, zëvendësohen me fjalët “Urdhri për konfiskimin e pasurisë” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

#### **Amendamenti 26**

Neni 24, paragrafi 1, në rreshtin e dytë, pas fjalës “sekuestrimit”, shtohen fjalët “e përkohshëm” dhe teksti vazhdon si në projektligj.